Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombetar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01 – 124
Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Qendra e Bukurisë "CAMELIAS"** në Prishtinë, për periudhën **07.02.2017** deri **07.02.2020** për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:

1.1. Grimer/Grimere; Niveli III sipas KKK,

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
   2.1 Të hartojë një model të strukturuar të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve {proces-verbal} i cili do të shërbejë si bazë dokumentimi për vlerësimin dhe nënshkrimin e anëtarëve të panelit vlerësues.
   2.2 Të rregullohet konforti në ambientet e qendrës {për sistemin ngrohje-ftohje}
   2.3 Të formatohet modeli me emërtimin CERTIFIKATË, per profesionin GRIMER/E në gjuhën shqipe për vlerësimin e kandidatëve në testimin në përfundim të gjithë trajnimit.
   2.4 Për të pasur një zbatim sa më të mirë të planprogramit të paraqitur nga qendra paneli konstaton që asistentët të trajnohen me pjesëmarrje të vazhdueshme në seminare në fushën e grimit në rajon, mundësisht të paraqitet një agjendë me takimet për këto seminare.

2.5 Të paraqitet një model i certifikatës me të cilën do të pajisen kandidatët në përfundim të trajnimit dhe në të jenë të paraqitura modulet dhe vlerësimet e arritura për gjithsecilin nga këto, si dhe vlerësimi në testin përfundimtar.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **31.05.2017,** në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:
   - CAMELIAS;
   - AKK.

Bedri Xhafa

Anëtari i KD së AKK-së